



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°11/2021

Hagë, 25/11/2021

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Ditën e hënë, të martë dhe të mërkurë të kësaj jave dhanë dëshmitë dëshmitari i tetë dhe dëshmitari i nëntë në gjykimin e Salih Mustafës. Dëshmitarët dëshmuan me masa mbrojtëse, ku përfshihet përdorimi i pseudonimit si dhe ndryshimi i fytyrës dhe zërit. Të dyve iu drejtuan pyetje nga ZPS-ja, Mbrojtja, mbrojtësja e viktimave dhe gjykatësit.

Ditën e martë, Trupi Gjykses I urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Mustafa. Gjykatësit konstatuan se ekziston ende rreziku që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHSK-së me anë të ndërhyrjes të viktimat dhe dëshmitarët.

Ligji parasheh që gjykatësit të rivlerësojnë çdo dy muaj nëse ekzistojnë ende arsye për mbajtjen në paraburgim të të akuzuarit. Këto arsye mund të jenë rreziku i arratisjes, rreziku i pengimit të procesit penal ose rreziku i kryerjes së të njëjtës vepër penale ose një vepër tjetër penale.

Ditën e martë, me kërkesë të gjykatësve, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi renditjen e re të dhënies së dëshmimeve prej dëshmitarëve për muajt janar dhe shkurt dhe vendosi të mos thërrasë një prej dëshmitarëve që kishte parashikuar fillimisht, pasi dëshmitarët e mëparshëm kanë dhënë tashmë të njëjtën dëshmi.

Seanca e ardhshme për këtë çështje do të mbahet më 13 dhjetor 2021, në orën 09:30.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°11/2021

Hagë, 25/11/2021

Në çështjen gjyqësore kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt, Trupi Gjykses II bëri me dije se brenda 26 nëntorit synon të nxjerrë vendim lidhur me kërkesat e ekipeve të Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave, në “Urdhrin për Planin e Punës dhe Caktimin e Afateve për Hapat e Ardhshëm të Procesit” të datës 9 nëntor 2021.

Në rast se gjykatësit refuzojnë kërkesën e ekipeve të Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave kundër të akuzuarve, atëherë më 2 dhe 3 dhjetor do të mbahet konferenca përgatitore për Mbrojtjen.

Të gjitha parashtrimet e protokolluara publike gjenden në faqen zyrtare të DHSK-së në internet.

Ndër lajme të tjera: ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara të Kosovës këtë javë u takua me grupe të ndryshme nga publiku i gjerë, të rinjtë dhe shoqëria civile në Llapllasellë, në zonën e Prishtinës dhe Gjilanit. Gjatë këtyre aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, ekipi dha informacion për mandatin dhe zhvillimet e fundit të proceseve të Gjykatës dhe iu përgjigj pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga pjesëmarrësit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

